



VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-korrik 2015 fq. 2
- » Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30.06.2015 fq. 3
- » Drejtimi i Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30.06.2015 fq. 4

LAJMET NGA RAJONI

- » Greqi fq. 5
- » Kosovë fq. 5
- » Maqedoni fq. 6
- » Moldavi fq. 6
- » Rumani fq. 7

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-korrik 2015

Tregu i sigurimeve u rrit me 21.04% gjatë periudhës janar-korrik 2015. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 7.7 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 9.16% duke arritur në 603,802 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 13.29% në krahasim me periudhën janar-korrik 2014. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.23 miliardë lekë, apo 70.15% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 24.56% gjatë periudhës janar-korrik 2015, krahasuar kjo me periudhën janar-korrik 2014.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 4.5 miliardë lekë gjatë periudhës janar-korrik 2015, duke shënuar një rritje prej 25.51% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 57.84% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 15.90% të tregut të Jo-Jetës;
- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 14.52% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 9.17% krahasuar me periudhën janar-korrik të vitit 2014. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori”, e cila përbën 64.47% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-korrik 2015

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30.06.2015

Gjatë periudhës janar-qershor 2015, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan aktivitetin e tyre dy fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve “Raiffeisen Prestigj” dhe Fondi i Investimeve “Raiffeisen Invest Euro”.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 30.06.2015, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti mbi 67.47 miliardë lekë me një rritje prej 5.85%, krahasuar me 31.12.2014.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 81.31% të aseteve të fondeve, me rritje prej 2.55% krahasuar me 31.12.2014.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 30.06.2015 ishte 34,098.

Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30.06.2015

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30.06.2015 tregon një total asetesh neto prej 754.83 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 125.68 milionë lekë (19.98%) krahasuar me fundin e vitit 2014. E shprehur në euro, totali i aseteve neto është 5.38 milionë euro. (Sipas <http://www.bankofalbania.org/> Kursi zyrtar i këmbimit ("fiksi") 30.06.2015 në Bankën e Shqipërisë, 1 euro = 140.29 lekë)

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 30.06.2015 ishte 10,791 anëtarë duke shënuar rritje prej 27.09% krahasuar me fundin e vitit 2014.


Tregues të fondeve të pensioneve

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera (mln. lekë)</i>		<i>Ndrvshimi (Në %)</i>
	<i>31.12.'14</i>	<i>30.06.'15</i>	
Asetet neto të FP	629.15	754.83	19.98


Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve

<i>Fond Pensioni</i>	<i>Numri i anëtarëve në FP</i>	<i>Asete Neto (mln. lekë)</i>
SIGAL	5,085	380.27
RAIFFEISEN	2,544	266.85
SiCRED PENSION	3,162	107.70
TOTAL	10,791	754.83

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve, 30.06.2015 (Në %)



Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve, 30.06.2015 (Në %)



LAJMET NGA RAJONI

GREQI

www.xprimm.com

Sipas raportit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, të publikuar nga Shoqata Greke e Kompanive të Sigurimit (HAIC), siguruesit grekë raportuan një vlerë të primeve të shkruara bruto prej 1.96 miliardë euro, në krahasim me 1.92 miliardë euro të kësaj periudhe një vit më parë. Raporti i publikuar nga HAIC përfshin shifrat për 57 sigurues që përbëjnë 95.8% të të dhënave të përgjithshme të tregut të sigurimeve. Nga këto 21 ishin shoqëri aktive në sigurimet e Jetës (97.4% e tregut) dhe 47 ishin aktive në sigurimet e Jo-Jetës (94.4% e tregut).

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, primet e shkruara bruto të sigurimit të Jo-Jetës përbënin 48.99% të totalit (960 milionë euro, ose 9% më pak se vitin e kaluar), ndërkohë që sigurimet e Jetës përfaqësonin pjesën e mbetur të tregut (afërsisht 1 miliardë euro, ose 15% më shumë sesa vitin e kaluar).

Në sigurimet e Jetës, policat tradicionale u rritën me 5% në krahasim me vitin e kaluar, ndërkohë që për produktet e lidhura me skema investimi u raportua një rritje e konsiderueshme prej më shumë se 45%. Në sigurimet e Jo-Jetës, klasat kryesore raportuan norma negative si: MTPL (-16.5%), Sigurimi Kasko (-9.1%), dhe sigurimi i pronave (-2.3%).

KOSOVË

www.xprimm.com

Gjatë periudhës janar-qershor 2015, tregu i sigurimeve në Kosovë ruajti rezultate të ngjashme me ato të raportuara në të njëjtën periudhë të vitit 2014. Sipas shifrave financiare të publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (CBK) primet e shkruara bruto ishin në vlerën prej 39.3 milionë euro, ndërkohë që vlera e dëmeve të paguara u rrit me 22% në krahasim me vitin e kaluar duke arritur në 19.4 milionë euro. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015, numri i policave të shitura nga kompanitë e sigurimit ishte 447.9 mijë, duke përfaqësuar një rritje vjetore prej 4.5%.

Në periudhën e analizuar, 68% e portofolit të primeve të shkruara bruto konsistuan në sigurimin motorik TPL, nga i cili rreth 55% (21.4 milionë euro) lidhej me klasën MTPL vendase, ndërkohë që policat kufitare gjeneruan prime të shkruara bruto në vlerën rreth 5.2 milionë euro.

Sipas sondazhit për kompanitë e sigurimit (*Insurance Companies Survey*) të publikuar nga CBK, në fund të muajit qershor të vitit 2015, rezervat teknike të tregut të sigurimeve në total arritën në 85.7 milionë euro ose 13.3% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, industria vendase e sigurimeve e mbylli vitin duke raportuar një humbje prej 2.55 milionë euro.

MAQEDONI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara në faqen zyrtare të Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, siguruesit maqedonas në fund të muajit mars të vitit 2015 raportuan një volum të primeve të shkruara bruto prej 34.86 milionë euro (2.14 miliardë MKD, monedha lokale), Kjo shifër është rreth 10.2% më e lartë sesa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Vlera e dëmeve të paguara gjithashtu u rrit me 16.4% në krahasim me vitin e kaluar, duke arritur në 13.3 milionë euro.

Në klasat kryesore të sigurimeve, sigurimet e Jetës zunë 9.2% të tregut në total (3.20 milionë euro, ose 19.8% më shumë sesa e njëjta periudhë e vitit të kaluar). Sigurimet e Jo-Jetës arritën në 31.65 milionë euro, (ose 9.3% më shumë sesa e njëjta periudhë e vitit të kaluar).

Ndër klasat kryesore në sigurimet e Jo-Jetës, volumi i primeve të shkruara bruto përbëhej nga rreth 43% sigurim motorik, 30% sigurim i pronave, 9.5% sigurimi ndaj aksidenteve, etj.

MOLDAVI

www.xprimm.com

Në një intervistë për Xprimm.com Jean Zenners, President i Këshillit të Byrove, shpjegon vendimin e majit të këtij viti të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Byrove (CoB) për sigurimet i cili vendosi që ta pezullojë Moldavinë nga Sistemi i Kartonit Jeshil duke filluar që nga 1 tetori 2015.

Z. Zenners shpjegon në intervistë se vendimi u mor pasi kompanitë moldave nuk arritën të përmbushin parimet bazë të Sistemit të Kartonit Jeshil: mbrojtja, besimi, stabiliteti financiar i kompanive, mashtrimi dhe aspekte që janë të lidhura me drejtimin e automjeteve pa u siguruar. Ai shton se për momentin mundemi vetëm të monitorojmë informacione të caktuara në lidhje me kompanitë dhe tregun moldav. Këto informacione do të analizohen nga Komiteti Monitorues i Sistemit të Kartonit Jeshil me fillimin e muajit shtator dhe më pas, Komiteti i Menaxhimit do të marrë një vendim për këtë çështje.

I pyetur nga Xprimm për pasojat e një pezullimi, Z. J. Zenners shprehet se para së gjithash kompanitë moldave të sigurimit nuk do të lejohen që të shesin më "Kartonin Jeshil", që do të thotë se ata do të humbasin një pjesë të rëndësishme të biznesit të tyre. Një çështje tjetër, drejtuesit moldavë të automjeteve nuk do të kenë mundësi që të shkojnë lirisht jashtë vendit pa blerë sigurime kufitare. Dhe sigurimi kufitar është shumë më i shtrenjtë sesa të blesh një Karton Jeshil. Gjithashtu, Byroja Moldave do të duhet të paguajë dëmet për policat e shitura më parë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Rumani njoftoi falimentimin e “ASTRA Asigurari”, siguruesit të tretë më të madh në vend, pas një viti e gjysmë administrimi të posaçëm.

Fondi i Garancisë së Sigurimeve në Rumani do të marrë në dorëzim detyrimet e dëmeve të “ASTRA Asigurari” brenda 30 ditësh nga njoftimi.

Duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2014, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë caktoi konsuletin KPMG si administrator të posaçëm të “ASTRA Asigurari” pasi zbuloi paaftësinë për të paguar dhe treguesit e likuiditetit të cilët nuk po përmbushnin sipas kriterëve ligjore.

“ASTRA Asigurari” kishte nevojë për një rritje kapitali prej 100 milionë euro, por aksionarët nuk mundën që t'i siguronin këto fonde dhe nuk u gjet asnjë investitor tjetër.